



# BULETIN JAVOR

## 19-23 SHKURT 2024

Shprehja

"Unë besoj se ne të gjithë do të jemi përgjegjës për sigurinë tonë - asnjë shitës, ofrues shërbimi, apo edhe ent qeveritar nuk do të na shpëtojë."

Sean Martin

e javës



### Shqipëria një Hap më Afër Sigurisë Kibernetike Globale AKCESK antarësohet në FIRST

Antarësimi i AKCESK në FIRST shënon një moment kyç në zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë kibernetike të Shqipërisë. Forumi Global i Ekipeve të Reagimit ndaj Incidenteve dhe Sigurisë (FIRST) është organizata kryesore dhe lideri global në reagimin ndaj incidenteve. Anëtarësimi në FIRST u mundëson ekipeve të reagimit ndaj incidenteve të përgjigjen në mënyrë më efektive ndaj incidenteve të sigurisë. Kjo marrëveshje e bën AKCESK një pjesë të rëndësishme të komunitetit global të reagimit ndaj incidenteve dhe sigurisë kibernetike përmes:

- Rritjes së reputacionit ndërkombëtar
- Ndërveprimit me ekspertizën më të mirë ndërkombëtare në luftën kundër kërcënimeve kibernetike.
- Aksesit në burime dhe platforma të specializuara mbi kërcënime të reja, teknikat e sulmit, dhe mjetet e avancuara të mbrojtjes kibernetike.
- Pjesëmarrje aktive në zhvillimin e standardeve dhe politikave



### Takim me grupin e deputetëve "Miqtë e fëmijëve" dhe shoqërinë civile

Në kryesinë e Kuvendit të Shqipërisë, të ftuar në një seancë publike me temë "Interneti i sigurt", Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve, Policia e Shtetit dhe AKCESK prezantuan para Grupit të Deputetëve "Miqtë e Internetit" disa nga masat për sigurinë online të fëmijëve. Organizata të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve ndanë gjithashtu disa aktivitete të tyre dhe disa rekomandime lidhur me këtë temë.

Të gjithë bashkë për parandalimin e hershëm dhe mbrojtjen e fëmijëve prej bullizmit, shantazhimit dhe abuzimit online!

### Përmbajtja:

- AKCESK antarësohet në FIRST- Shqipëria një Hap më Afër Sigurisë Kibernetike Globale
- Takim me grupin e deputetëve "Miqtë e fëmijëve" dhe shoqërinë civile
- Tik Tok -data breach
- ConnectWise- patching alert



### Tik Tok - data breach

Bashkimi Evropian (BE) po hap një hetim zyrtar ndaj TikTok mbi shkeljet e mundshme të përmbajtjes në internet, duke e vënë platformën në rrezik të një gjobe të konsiderueshme. Hetimi do të fokusohet në hartimin e sistemit të TikTok, duke përfshirë sistemet algoritmike që mund të stimulojnë varësi të sjelljes së përdoruesve.

Komisioni Evropian do të hetojë gjithashtu nëse TikTok ka vendosur masat e duhura për të garantuar një nivel të lartë privatësie dhe sigurie për të miturit.

[Link: Lexo më shumë](#)

### PATCHING ALERT



### ConnectWise - patching alert

ConnectWise ka nxjerrë një paralajmërim për klientët të përditësojnë serverët e tyre ScreenConnect për të parandaluar një vulnerabilitet që mund të përdoret në sulmet e ekzekutimit të kodit në distancë (RCE). Vulnerabiliteti është për shkak të një dobësie të anashkalimit të vërtetimit që sulmuesit mund ta shfrytëzojnë për të fituar akses në të dhënat konfidenciale ose për të ekzekutuar kodin arbitrar nga distanca.

ConnectWise ende nuk i ka caktuar ID-të e CVE-ve për dy të metat e sigurisë, por partnerët këshillohen që të përditësojnë serverët e tyre në versionin ScreenConnect 23.9.8 menjëherë.

[Link: Lexo më shumë](#)